

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

PROJEKT-BUXHETI I VITIT 2023

Tiranë më 29 Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA:

I. Hyrja

II. Treguesit kryesorë financiar të ASD në vite

III. Projekt-Buxheti i vitit 2023

IV. Parashikimi i treguesve ekonomik të ASD për vitin 2023

V. Aneksat e Projekt-Buxhetit të vitit 2023

Aneks 1: Pasqyra e Projekt Buxhetit të të Ardhurave për vitin 2023

Aneks 2: Pasqyra e Projekt Buxhetit të Shpenzimeve Korrente për vitin 2023

Aneks 3: Pasqyra e Projekt Buxhetit të Shpenzimeve Kapitale për vitin 2023

Aneks 4: Pasqyra e Llogaritjes së Fondit të Pagave për vitin 2023

Aneksi 5: Pasqyra e Llogaritjes së Shpërblimeve të Këshillit Drejtues

Aneksi 6: Pasqyra e Llogaritjes së Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore

I. HYRJE

Projekt-buxheti i ASD për vitin 2023 përfaqëson parashikimin e situatës financiare të Agjencisë, përdorimin e burimeve të saj financiare me efektivitet, me qëllim arritjen e objektivave në mbrojtje të depozituesve dhe të konsolidimit të besimit të tyre në sistemin financiar.

Projekt buxheti i ASD për vitin 2023 është përgatitur bazuar në Ligjin 53/14 datë 22.05.2014, “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, Rregulloren “për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit drejtues, Nr. 34, datë 27.11.2020.

Projekt buxheti i vitit 2023 është produkt i një angazhimi gjithëpërfshirës të strukturave të Agjencisë, me angazhim të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm, Zv/ Drejtorëve të Përgjithshëm dhe Përgjegjësve të Sektorëve. Në hartimin e tij u mbajtën parasysh objektivat prioritare të ASD për vitin 2023 të cilat janë përfshirë në planin strategjik të Agjencisë për vitet 2021-2023, nga njësitë përkatëse. Gjithashtu, është analizuar ecuria e shpenzimeve faktike në vite dhe nevojat e identifikuara për vitin 2023.


II. TREGUESIT KRYESORË FINANCIAR TË ASD NË VITE

Treguesit kryesor financiarë të ASD, krahasuar nga njëri vit në tjetrin, paraqiten si më poshtë.


	2022		2023		Ndryshimi Plan 2023- Plan 2022	Ndryshimi Plan 2023- Realizimi i pritshem 2022
	Plan	Realizimi I Pritshem	Plan			
Te Ardhurat nga Administrimi i Mjeteve Monetare	1,425,434,700	1,721,521,352	2,123,240,628	148.95%	123.34%	
Te Ardhura nga Aktiviteti Sigurues	3,819,500,000	4,017,552,725	3,821,000,000	100.04%	95.11%	
Te Ardhura nga Veprimtari te Tjera- Administrimi FNJ	2,318,400	2,318,400	2,898,000	125.00%	125.00%	
Total te Ardhurash	5,247,253,100	5,741,392,477	5,947,138,628	113.34%	103.58%	
Shpenzime Korrente (Pa Amortizim/provigjione/humbje/fitim nga kursi)	250,769,032	210,612,662	212,392,208	84.70%	100.84%	
Shpenzime amortizimi/provigjioni/humbje nga kursi i këmbimit	18,872,206	6,875,162	17,521,643	92.84%	254.85%	
Shpenzime Kapitale	15,200,000	13,928,080	16,960,000	111.6%	121.8%	
Total Shpenzimesh	284,841,237	231,415,904	246,873,851	86.67%	106.68%	
Shpenzime Korrente/Te Ardhura nga Administrimi i Mjeteve Financiare	17.59%	12.23%	10.00%			
Shpenzime Kapitale/Te Ardhura nga Administrimi i Mjeteve Financiare	1.07%	0.81%	0.80%			
Shpenzime korrente +kapitale/ Te Ardhura nga Administrimi i Mjeteve Financiare	18.7%	13.0%	10.8%			
Shpenzime Korrente/Te Ardhurat Total	4.8%	3.7%	3.6%			
Shpenzime Kapitale/Te Ardhurat Total	0.3%	0.2%	0.3%			
Shpenzime Total (korrente+kapitale)/Te Ardhura Total	5.4%	4.0%	4.2%			

II. TREGUESIT KRYESORË FINANCIAR TË ASD NË VITE

Më poshtë paraqitet në formë grafike ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve në vitet 2018-2022, si dhe parashikimi për vitin 2023.




Të ardhurat totale për vitin 2023 janë parashikuar me një rritje 3.5% krahasuar me realizimin e pritshtëm për vitin 2022 dhe me rritje 13.3% krahasuar me planin e këtij viti.




Përsa i përket Primit të paguar nga bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit ato paraqiten si mëposhtë;


Primi i Bankave




Prime / Kontribut fillestare SHKK



Të ardhurat nga investimet për 2023 janë planifikuar me rritje 23.3% krahasuar me realizimin e pritshëm 2022 dhe me rritje 48.9% nga plani i vitit 2022.




Shpenzimet korrente (duke përfshirë amortizimin dhe provigjionin, por duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit) sipas projekt buxhetit, priten të jenë 15% më pak krahasuar me planin e vitit 2022 dhe 5% më shumë krahasuar me realizimin e pritshëm. Në grafikun në vijim, paraqitet edhe ecuria e shpenzimeve në pesë vitet e fundit dhe planifikimi për vitin 2023.



Më poshtë paraqiten në formë grafike ndryshimet në zërat kryesore të shpenzimeve korrente ndërmjet realizimit të pritshëm për vitin 2022 dhe planit të vitit 2023.

Ndryshimet në Shpenzimet Korrente - Plan 2023 me Realizim i Pritshëm 2022



Nga grafiku, evidentohet një rënie e konsiderueshme në zërin shpenzime financiare, si vijimësi e planifikimit të shpenzimeve financiare për efekt të realizimit të kontratës së linjës së kredisë me BERZH.

Një rritje në zërat e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023 evidentohet në zërin “Shpenzime personeli”, i cili ka një diferencë jo të lartë krahasuar me planin e vitit 2022, por më të lartë krahasuar me realizimin e pritshëm, i cili është i ndikuar edhe nga situata e krijuar si pasojë Covid-19.

Zë tjetër, i cili shënon rritje krahasuar me realizimin e pritshëm është zëri “Shpenzime trajnimi dhe specializimi të stafit”, rritje e cila vjen si rezultat i mosrealizimit të fondit për efekt të situatës së krijuar nga Covid- 19.

Gjithashtu, zëri “Shpenzime për konsulecë dhe auditimi”, ka shënuar rritje krahasuar me realizimin e pritshëm të vitit 2022, rritje e cila vjen si rezultat i mos realizimit të fondit për rishikimin e Manualit të Kontabilitetit në shumën 1,500,000 lekë. Ky fond është mbartur në vitin 2023, dhe parashikimi i Penetration test i sistemit informatik qëndror.

Në grafikun në vijim, paraqiten ndryshimet në zërat kryesorë të shpenzimeve korrente në projekt buxhetin e vitit 2023, në krahasim me buxhetin e vitit 2022.

Ndryshimet në Shpenzime Korrente - Plan 2023 me Plan 2022



Në grafik evidentohej ulje të planifikuara gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 në zërat:

- “Shpenzime amortizimi”, të cilat janë në ulje si pasojë e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale ekzistuese. Të vetmet aktive jo materiale që pritet të amortizohen këtë vit janë AJM që do blihen gjatë vitit 2023.
- “Shpenzimet për trajnime” janë parashikuar në ulje të lehtë krahasuar me planin e vitit 2022, ky parashikim edhe bazuar në realizimin në vite dhe realizimin e pritsëm për vitin 2022.
- Shpenzime “Konsulenca dhe Auditim” janë parashikuar në rritje si pasojë kryesisht e zërit Penetration Test për sistemin informatik qëndror 2,200,000 lekë.
- Shpenzime “Mirëmbajtje riparime të mjeteve kryesore” janë parashikuar në rritje si pasojë e shtesës së Licensë Windos Pro 10 në vlerë 600.000 lekë, dhe rishikimit në rritje të disa shpenzimeve të tjera.

III. PROJEKT BUXHETI I VITIT 2023

Misioni i Agjencisë është administrimi i skemës së sigurimit të depozitave me qëllim përmbushjen e objektivave publike të skemës, në mbështetje dhe në zbatim të ligjit. Në hartimin e këtij projekt buxheti Agjencia ka marrë në konsideratë objektivat e secilit sektor për vitin në vijim.

Projekt Buxheti i vitit 2023 kontribuon që Agjencia të përmbushë objektivat e saj për vitin në fjalë në funksion të zbatimit të kërkesave të ligjit. Ndër të tjera në hartimin e këtij Projekt – Buxheti Agjencia ka patur në vëmendje këto parime:

- Të shërbejë si instrument drejtimi dhe kontrolli për mirëmenaxhimin financiar të institucionit për vitin 2023.
- Të administrojë me efikasitet mjetet financiare, duke pasur gjithmonë në vëmendje parimet e mirëmenaxhimit të rreziqeve dhe zbatimin e rregullores për Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare, si për fondin e sigurimit në Banka dhe atë në SHKK.
- Të përballojë koston e veprimtarisë operative dhe administrative nga të ardhurat e realizuara nga investimi i mjeteve financiare.
- Të mundësojë burimet e nevojshme për realizimin e simulimeve të një ngjarje kompensimi me subjektet anëtare të skemës.
- Të zhvillojë më tej marrëdhëniet me homologët në rajon, por edhe më gjerë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe bashkërendimin e punës si anëtare të organizatave si IADI dhe EFDI.
- Të krijojë kushte dhe të sigurojë mundësinë për rritjen e nivelit profesional të punonjësve me dije bashkëkohore, nëpërmjet specializimeve dhe kualifikimeve që do të kryhen gjatë vitit 2023.
- Të krijojë kushte për zbatimin e politikave bashkëkohore të edukimit të publikut, jo vetëm me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, por edhe me publikun e gjerë, me qëllim rritjen e besimit të saj institucional dhe rrjedhimisht në sistemin financiar në vend.
- Të krijojë kushtet e nevojshme infrastrukturore për t'iu përgjigjur ndryshimeve në strukturën organike të Agjencisë.
- Të përmirësojë dhe mirëmbajë infrastrukturën e përgjithshme të punës, si dhe atë të teknologjisë së informacionit.

Projekt-Buxheti i vitit 2023 paraqitet për t'u shqyrtuar mbi bazën e nivelit të treguesve të mëposhtëm:

1. Të ardhura nga primi i sigurimit nga subjektet anëtare të skemës.
2. Të ardhura nga administrimi i mjeteve financiare të ASD.
3. Të ardhura nga administrimi i mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
4. Shpenzimeve korrente në bazë të nevojave të evidentuara për vitin 2023.
5. Shpenzimeve kapitale në bazë të nevojave të evidentuara për vitin 2023.

IV. PARASHIKIMI I TREGUESVE EKONOMIK TË ASD PËR VITIN 2023

Parashikimi dhe llogaritja e treguesve ekonomik, si dhe faktorët që ndikojnë në to, parashtrohen në vijim të këtij projekt buxheti për vitin 2023.

Parashikimi i të Ardhurave të Agjencisë për vitin 2023

Të ardhurat e Agjencisë për vitin 2023 parashikohen 5,947,138,628 lekë (13.3 % më shumë se plani dhe 3.5 % më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 2020. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga primet vjetore në vlerën 3,821,000,000 lekë (pothuajse sa plani 2022 dhe 5% më pak se realizimi i pritshëm i vitit 2022), të ardhurat nga interesat në investime në vlerën 2,123,240,628 lekë (48.9% më shumë se plani dhe 23.3 % më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022), dhe të ardhura nga tarifa vjetore e administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vlerën 2,898,000 lekë, sipas përcaktimit në nenin 16 të Rregullores nr. 56 datë 03.10.2017 “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, si edhe në shkresën e BSH nr. 800/1 datë 22.02.2019 miratuar nga Zv.Guvernatori i Dytë. (25% më shumë se plani për vitin 2022).

Burimet për realizimin e të ardhurave për vitin 2023 do të jenë:

A. Të ardhurat nga Primi i Sigurimit të Bankave për vitin 2023

Të ardhurat nga primet tremujore të sigurimit që bankat do të paguajnë për vitin 2023, parashikohen në vlerën 3,800,000,000 lekë (sa plani dhe 5% më pak se realizimi i pritshëm për vitin 2022) dhe janë të ardhurat më të rëndësishme në portofolin e ASD-së.

Primi i sigurimit të depozitave në sistemin bankar është burimi kryesor i mjeteve monetare të Agjencisë. Duke ju referuar ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, primi tremujor i sigurimit për bankat është 0,125% e mesatares aritmetike të shumës të depozitave të siguruara, që janë të regjistruara në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Aktualisht, norma vjetore e primit të sigurimit të depozitave është e njëjtë për të gjitha bankat e sistemit, e cila do të vazhdojë kështu edhe për vitin 2022. Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, Agjencia, edhe për vitin 2022, do të vazhdojë të sigurojë depozitat në masën 2,500, 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë, për çdo depozitues në secilin subjekt të siguruar.

Për vitin 2023, parashikimi është mbështetur në parashikimet paraprake nga bankat, të mbledhura nga Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, si edhe në analizën e kryer nga Sektori i Analizës së Riskut në Agjenci. Në zbatim të Udhëzimit ”Mbi marrëdhëniet e ASD-së me bankat e siguruar”, bankat kanë dërguar parashikimet e tyre paraprake për primin vjetor të sigurimit për vitin 2023.

Në tabelën e mëposhtme jepen parashikimet e kryera nga Bankat (SSKD) si edhe nga SAR në lidhje me parashikimin e primit për vitin 2023:

Nr	Emërtimi	Shumat në lekë	Ndryshimi në %
1	Primi Faktik 2022	3,996,507,9223	-
2	Parashikim Bankat (SSKD)	3,728,000,000	-2%(ndryshimi me planifikimin prim '22)
3	Parashikimi nga SAR	4,200,000,000	10%(ndryshimi me planifikimin prim'22)
4	Parashikimi Buxhet 2023	3,800,000,000	0% (ndryshimi me planifikimin prim'22)

Agjencia në planifikimin e të ardhurave nga primi i sigurimit për Fondin Banka për vitin 2023 ka konsideruar një rritje prej 5.5% të primit, duke u mbështetur kryesisht në të ardhurat nga arkëtimi i primit për vitin 2022 duke mbetur i kujdesshëm në parashikim.

B. Të ardhurat nga Primi i Sigurimit të SHKK-ve për vitin 2023

Një tjetër burim kryesor i të ardhurave janë edhe primet tremujore të SHKK-ve. Të ardhurat nga këto prime parashikohen në vlerën 21,000,000 lekë (7.5% më shumë se plani dhe pothuajse sa realizimi i vitit 2022).

Referuar ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, primi tremujor i sigurimit për SHKK-të është 0,075 % e mesatares aritmetike të shumës të depozitave të siguruar, që janë të regjistruara në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Aktualisht, norma vjetore e primit të sigurimit të depozitave është e njëjtë për të gjitha SHKK-të e sistemit, e cila do të vazhdojë kështu edhe për vitin 2022. Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, Agjencia, edhe për vitin në vijim, do të vazhdojë të sigurojë depozitat në masën 2,000,000 (dy milionë) lekë, për çdo depozitues në secilin subjekt të siguruar.

Për vitin 2023 parashikimi është mbështetur në parashikimet paraprake nga SHKK-të të mbledhura nga Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave në Agjenci, si edhe në realizimin e pritshëm për vitin 2022, siç jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Shumat në lekë	Ndryshimi në %
1	Primi Faktik 2022	21,044,803	-
2	Parashikim SHKK-të (SSKD)	22,608,000	14% (ndryshimi me planifikimin prim '22)
3	Parashikimi Buxhet 2023	21,000,000	7% (ndryshimi me planifikimin prim'22)

Agjencia në planifikimin e të ardhurave nga primi i sigurimit për Fondin SHKK për vitin 2023 ka konsideruar një rritje prej 7% të primit, krahasuar me planin 2022 duke mbetur i kujdesshëm në parashikim.

C. Të Ardhurat nga Investimi i Mjeteve Financiare

Të Ardhurat nga Investimi i Mjeteve Financiare, janë burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave për Agjencinë. Në zbatim të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, kreu IV, “Administrimi i Mjeteve Financiare”, të rregullores “Për Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të ASD-së”, të ndryshuar, në strategjinë paraprake të investimit për vitin 2023, si dhe bazuar në analizën e të dhënave të viteve të mëparshme, është parashikuar që të ardhurat nga investimi i mjeteve financiare për vitin 2023 të jenë 2,123,240,628 lekë (48.9% më shumë se plani për vitin 2022 dhe 23.3% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022)

Të ardhurat janë planifikuar duke marrë në konsideratë:

- Të ardhurat nga investimet e kryera në vitet e kaluara, të cilat gjenerojnë të ardhura për vitin 2023;
- Të ardhurat nga investimet që maturohen dhe do të ri-investohen në vitin 2023;
- Të ardhurat nga investimet e primeve tremujore për vitin 2023 nga Bankat dhe SHKK;
- Flukset dalëse për shpenzimet korrente dhe ato kapitale të planifikuara për vitin 2023;
- Treguesit ekonomiko-financiar dhe parashikimet për kalendarin e emetimeve dhe normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare.
- Objektivit të Politikës për një shpërndarje të përshtatshme dhe harmonike të maturiteteve të portofolit.

Nga këndvështrimi i strukturës së investimit, Portofoli i Investimeve të ASD-së duhet të ruajë tre kufij kryesorë: transhin e likuiditetit, transhin e investimeve, si dhe shpërndarjen në bazë të monedhës.

Transhi i Likuiditetit :

- jo më pak se 10% e totalit të portofolit të mjeteve financiare. Ky transh përfshin gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur 0 - 3 muaj të Agjencisë.

Transhi i Investimit:

- Transhi i investimit përfaqëson mjetet financiare pasi zbritet transhi i likuiditetit dhe përfshin mjetet financiare me maturitet të mbetur mbi 3 muaj deri në 15 vjet, duke u përpjekur të kemi një shpërndarje sa më të shkallëzuar (zvogëlim të luhatjeve) të maturiteteve nga muaji në muaj për efekt planifikimi. Titujt me maturitet të mbetur mbi 2 vjet nuk mund të kenë një vlerë më të madhe se 30% e totalit të mjeteve financiare të Agjencisë.

Për vitin 2023 është parashikuar e njëjta skemë investim si ajo e vitit 2022, me një rritje të matur të nënportofolit në monedhën euro duke patur si synim mbajtjen e mjeteve të investuara në këtë monedhë në masën 12% të totalit të mjeteve financiare të Agjencisë. Si rrjedhojë, në vlerë të përafërt rritja e portofolit të mjeteve do të jetë në shumën 2 miliard lekë, shumë e cila do të përdoret në investimet në maturitetet mbi 2 vjet në eurobondin me maturitet 2031. Është parashikuar gjithashtu, investimi prej 13 milion euro.

Investime në bazë të monedhës :

- Jo më pak se 5% e portofolit të mjeteve financiare duhet të mbahen në monedhën EUR ose USD. Për vitin 2023, Agjencia ka planifikuar vazhdimin e investimeve të mjeteve financiare në monedhën euro në tregje ndërkombëtare, kryesisht në eurobondin e Qeverisë Shqiptare me maturitet 2031. Gjithashtu është planifikuar që mjetet financiare në monedhë të rriten me afërsisht 13 milionë euro (afërsisht 2 miliard lekë), gjatë vitit 2023, shumë e cila do të merret gradualisht nga primet tremujore të bankave.

Gjithashtu përveç strukturës së investimit, përllogaritja e të ardhurave nga investimi i mjeteve financiare varet shumë edhe nga ecuria e normave të interesit për instrumentet financiarë. Përllogaritja e të ardhurave është bazuar në normat e interesit të parashikuara për vitin 2023 (duke marrë në konsideratë zhvillimet që i kanë karakterizuar ato gjatë vitit 2022 dhe pritshmëritë për vitin 2023).

Vlen të theksojmë që ndryshimet e normave të interesit tej parashikimeve të bëra për efekt planifikimi ose ndryshimet në strategjinë e investimit për vitin 2023 nga ato të përdorura për efekt planifikimi, mund të ndikojnë në realizimin e këtij zëri të të ardhurave.

Përmbledhje e Situatës Ekonomiko-Financiare të Shqipërisë

Për vitin 2022, situata ekonomike dhe financiare e Shqipërisë bazuar në raportin e tremujorit të katërt të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë, paraqitet si në vijim:

Rritja ekonomike

Ndonëse rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv, ajo ka filluar të shfaqë shenja ngadalësimi pas tremujorit të parë. Nga ana tjetër, inflacioni ka ardhur në rritje progresive gjatë vitit 2022, duke shënuar nivelin 8.1% në muajin shtator. Rritja e inflacionit është nxitur nga rritja e çmimeve në tregun ndërkombëtar, por ajo ka filluar të transmetohet edhe në rritje të kostove të prodhimit dhe të pritjeve për inflacionin në vend. Për këto arsye, rritja e çmimeve në vend duket të ketë një bazë të gjerë dhe të jetë relativisht e qëndrueshme.

Ecuria e Normës së Inflacionit

Inflacioni do të mbetet i lartë deri në fillim të vitit 2023, por ai parashikohet të ulet gradualisht më pas, drejt objektivit tonë prej 3%. Nivelet e larta të inflacionit në afatin e shkurtër do të pasqyrojnë si veprimin e faktorëve globalë – çmimet e larta të ushqimeve dhe të naftës në tregjet botërore – ashtu dhe veprimin e faktorëve të brendshëm – rritjen e kërkesës, punësimit, pagave dhe pritjet e larta inflacioniste. Nga ana tjetër, rënia e inflacionit përgjatë vitit 2023 faktorizon rënien e pritur të inflacionit të ushqimeve dhe të naftës në tregjet botërore, si pasojë e efektit bazë dhe stabilizimit të çmimeve të lëndëve të para.

Ecuria e Kursit të Këmbimit


Leku ka vijuar të mbiçmohet kundrejt euros edhe në tremujorin e tretë të vitit, përtej sa dikton sjellja sezonale, por duke mbetur brenda parametrave normalë të tregtimit. Mbiçmimi i lekut kundrejt euros, i nisur që prej fundit të muajit prill, kulmoi në tremujorin e tretë; kursi eur/lek rezultoi mesatarisht 117.1 lekë/euro, nga 120.4 lekë/euro që ishte në tremujorin e dytë të vitit dhe 121.9 lekë/euro në tremujorin e parë të tij. Në tre javët e para të muajit tetor, kursi eur/lek është luhatur pranë nivelit mesatar të muajve shtator dhe gusht, me një mbiçmim vjetor të lekut prej 3.9%.

- Ecuria e Yield-ve në Tregun Primar

Yield-et e titujve sovranë janë rritur ndjeshëm dhe kanë reflektuar si shtrëngimin e kushteve monetare, ashtu dhe primet e rrezikut për rritjen e barrës së borxhit publik. Kostot e financimit të sektorit privat janë shtrënguar, ku krahas rritjes së normave bazë nga bankat qendrore, ato kanë faktorizuar edhe perspektivën e dobët të aktivitetit ekonomik.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë janë rritur më tej në tremujorin e tretë të vitit. Ecuria e tyre ka reflektuar rritjen e normës bazë, si edhe pritjet e agjentëve të tregut për forcën dhe ritmin e normalizimit të politikës monetare në të ardhmen e afërt. Ndryshimet e fundit të normës bazë, konteksti aktual i shënjuar nga inflacioni i lartë, si dhe pritjet e tregut për reagimin e mëtejshëm të politikës monetare, duken t'iu kenë orientuar bankat në kërkimin e yield-eve të larta. Këto zhvillime janë reflektuar edhe tek oferta në ankande, e cila ka treguar shenja kujdesi dhe një preferencë për afate të shkurtra maturimi. Prej fillimit të normalizimit të politikës monetare, diferencat e yield-it të letrave me vlerë të qeverisë ndaj normës bazë kanë ardhur duke u zgjeruar. Bonoja 12-mujore, e përdorur gjerësisht si parametër në çmimin e titujve afatgjatë, ka shënuar 5.26% në ankandin e fundit në muajin tetor, nga 2.84% që shënonte në muajin korrik. Rritje të ngjashme kanë shënuar edhe yield-et e obligacioneve. Nivelet e tyre aktuale gjenden mesatarisht 1.6 p.p. mbi ato të muajit korrik, si dhe 2.9 p.p. mbi nivelet e fillimit të vitit¹⁰. Rritja është shtrirë në mënyrë uniforme tek të gjitha maturitetet. Në këtë mënyrë, kurba e yield-eve është zhvendosur në një nivel më të lartë, por pa pësuar ndryshime të qenësishme në pjerrësinë e saj

Në grafikët në vijim, jepet ecuria e yield-eve gjatë periudhës nëntor 2019 - nëntor 2022 për Bonot e Thesarit 3, 12 mujore dhe obligacionet e Qeverisë Shqiptare 2 V, 3V, 5V, 7V, 10V, 15V.



- Ecuria e Financimit të Sektorit Publik

Deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve u zgjerua me 41.3%, si pasojë e rritjes së fortë të importeve me 17.6%. Ndikimi ka ardhur kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve me 35.9%, ndërkohë që importi i mallrave është zgjeruar me 11.5%. Në rastin e eksporteve, rritja paraqitet e ngadalësuar gjatë tremujorit të dytë të vitit (9.1% kundrejt 25.6% në tremujorin e parë). Ndikimet buruan si nga rritja e eksportit të shërbimeve, (6.9%) ashtu edhe nga mallrat (14.5%).

- Yield-et e Bonove të Thesarit dhe Obligacioneve në Lekë të marra në konsideratë për planifikimin e të ardhurave për vitin 2022

Për vitin 2023, parashikimi i nivelit mesatar të yield-eve për çdo maturim është bazuar në të dhënat historike mbi ecurinë e tyre, në rezultatet e ankandeve të vitit 2022. Gjatë vitit 2022 ka patur një tendencë në rritje të yeildeve, ndikuar nga situata ekonomiko financiare, inflacioni dhe rritja e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë.

Agjencia parashikon një rënie të lehtë të yield-it të Bonove të Thesarit dhe Obligacioneve të Qeverisë Shqiptare duke patur parasysh trendin e ankandeve të fundit. Investimet e Agjencisë për vitin 2022 paraqiten në tabelën më poshtë:

Portofoli I investimeve ne nominal	Vlera	Yeldi I planifikuar
Bono thesari 12 mujore	9,600,000,000.00	3.55%
Obligacione te qeverise shqiptare 2 vjecare	14,400,000,000.00	4.05%
Obligacione te qeverise shqiptare mbi 2 vjet	2,000,000,000.00	5.25%-6.25%%
Obligacione te qeverise shqiptare 10 vjecare euro	15.000.000	2.7%

Të Ardhurat nga Investimet në LEK - Fondi Banka (neto për amortizimin e prim/skontos), parashikohen në shumën 1,904,512,736 lekë (45% më shumë se sa plani dhe 21.4 % më shumë se sa realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Planifikimi i të Ardhurave nga Investimet në Lekë për Fondin Banka është bërë duke u mbështetur në:

- Të ardhurat nga interesat nga investimet në BTH të cilat do të maturohen gjatë vitit 2022 janë parashikuar në masën 159,252,573 lekë.
- Të ardhura nga obligacionet me maturitet 2 vjeçar të investuara në vitin 2021 dhe 2022, përfshirë edhe rihapjet janë parashikuar në masën 460,496,541 lekë.
- Të ardhurat nga interesat nga investimeve në obligacione me kupon fiks me maturitet mbi 2 vjet të kryera në vitet e kaluara dhe që 684,577,052 lekë.
- Të ardhurat nga ri-investimi i BTH gjatë vitit 2023 janë parashikuar në masën 170,510,317 lekë.
- Të ardhura nga ri-investimi i obligacioneve 2 vjeçare me kupon fiks që maturohen gjatë vitit 2023 janë parashikuar në vlerë 311,545,698 lekë.
- Të ardhura nga ri-investimi i obligacioneve mbi 2 vjeçare me kupon fiks që maturohen gjatë vitit 2023 dhe i një pjese të primit të arkëtuar, në maturitetin mbi 2 vjet janë parashikuar në vlerë 118,130,556 lekë.

Niveli i të ardhurave të planifikuara për vitin 2023 në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2022 është rezultat kryesisht i rritjes së normave të interesit të rezultuara gjatë vitit 2022 dhe rritjes së vazhdueshme të portofolit të Agjencisë. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë respektimin e transheve të investimit, Agjencia ka shtuar portofolin e saj në investimet me maturitet të largët mbi 2 vjet, gjë e cila përkthehet në norma më të larta kthimi të interesit.

Të Ardhurat nga investimet në monedhë të huaj – Fondi Banka (neto për amortizim prim/skonto), parashikohen në shumën 163,484,000 lekë (60% më shumë se plani dhe 29% më shumë se realizimi i pritshëm i 2022).

Portofoli i instrumenteve financiare në valutë, është krijuar në zbatim të Rregullores për Politikën e Investimit dhe ka si qëllim diversifikimin e portofolit sipas valutave dhe administrimin e likuiditetit.

Rritja në të ardhurat e parashikuara për këto instrumente vjen si rezultat i këtyre faktorëve:

- Agjencia në strategjinë paraprake të investimeve ka planifikuar një shtim të mjeteve financiare në valutë në masën afërsisht 15,000,000 euro, të cilat planifikohen të merren nga primi tremujor pas hyrjes së primit nga bankat, dhe një pjesë nga gjendja cash që ka Agjencia. Pjesa e mbetur do të plotësohet nga vlera e kuponave për investimet ekzistuese. Për një planifikim më të kujdesshëm janë parashikuar të ardhura nga ky fond me një yield mesatar prej 2.7%.
- Është konsideruar që kursi i këmbimit (Eur/Lek=120);

Të ardhura nga depozitat – Fondi Banka janë llogaritur në vlerën 47,463,605 lekë (INF më shumë se plani dhe INF shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Të ardhurat nga depozitat janë të ardhura që sigurohen nga interesat e investimit në depozitë një javore të fondeve të lira të ASD-së pranë Bankës së Shqipërisë sipas marrëveshjes së përbashkët ndërmjet dy institucioneve. Depozitat janë instrumenta likuid, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e objektivit të Agjencisë për ndërtimin dhe ruajtjen e një shpërndarje maturiteti të shkallëzuar të portofolit në përputhje me Politikën e Investimeve. Llogaritja e tyre është bërë duke u bazuar në gjendjen e fondeve të lira në llogarinë rrjedhëse pranë BSH-së në monedhën lekë në fund të vitit, e cila planifikohet të qëndrojë për gjatë gjithë vitit në vazhdim në depozitë një javore, me qëllim ruajtjen e raporteve sipas transheve.

Shuma e planifikuar për investim në depozitë 7 ditore përgjatë gjithë vitit 2023 për fondin Banka është 1.8 miliard lekë e llogaritur me normën e interesit prej 2.65% të depozitës një javore të ofruar nga Banka e Shqipërisë. Diferenca e lartë krahasuar me planin dhe realizimin e pritshëm 2022 vjen si pasojë e rritjes së normës së depozitës nga 0.4% në 2.65%.

Të Ardhurat nga Investimet në LEK - SHKK, parashikohen në shumën 7,540,152 lekë (43% më shumë se plani dhe po aq më shumë se realizimi i pritshëm për 2022). Rritja në të ardhura vjen si rezultat i rritjes së shumës së investuar në dispozicion dhe rritjes së normës së interesit. Aktualisht fondi i Shoqërive Kursim Kredi është investuar në maturitet 7 vjeçar, 2 vjeçar i cili nuk pritet të maturohet gjatë vitit 2023. Nje pjesë e fondit është investuar në BTH 3 mujore me qëllim ruajtjen e transhit të likuiditetit. Investimet për vitin 2023 do të vijnë si pasojë e mbledhjes së primit për këtë vit, si edhe një pjesë nga riinvestimet gjatë vitit 2022.

Të ardhura nga depozitat - SHKK – parashikohen në vlerë 240,134 lekë, parashikohet investimi në depozita për vlerat në gjëndje nga momenti i derdhjes së primit në momentin e organizmit të ankandeve të rradhës. Parashikimi është bërë, me normë interesi 2.65%.

Të Ardhurat nga Kontribute, Kredi, Hua, Donacione, Subvencione të Ndryshme

Në këtë kapitull parashikohen të ardhurat nga grante të ndryshme siç ishte ai i BERZH-it për mirëmbajtjen e programit të raportimit dhe kompensimit, të cilat për vitin 2023 janë në vlerën zero.

Të Ardhura nga Veprimtari të Tjera

Në këtë zë është parashikuar e ardhura nga administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, e cila do t'i rimburohet Agjencisë për kostot e personelit të angazhuar në administrimin e këtij fondi. Ky zë është parashikuar në zbatim të nenit 16 të VKM nr. 56 datë 03.10.2017 të Bankës së Shqipërisë, për miratimin e Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Procedurat për Administrimin e tij”. Parashikimi për vitin 2023 është në vlerën 2,898,000 lekë (25.8% më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2022). Ky parashikim është mbështetur në kufirin orientues prej 0.08% të shumës së investuar për vitin 2021 të përcaktuar në shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.800/1 datë 22.02.2019 miratuar nga Zv.Guvernatori i dytë.

Parashikimi i Shpenzimeve të ASD për vitin 2023

Parashikimi mbi përlllogaritjen e shpenzimeve për Projekt-Buxhetin e vitit 2023 është bazuar në analizën e kryer mbi realizimet e Buxheteve të viteve paraardhëse, realizimit të pritshëm të vitit 2022, si dhe kërkesave të sektorëve përkatës për vitin në vijim.

Shpenzimet janë grupuar sipas dy kategorive kryesore, në **Shpenzime Korrente** (me një vlerë 229,913,850 lekë) dhe në **Shpenzime Kapitale** (me një vlerë 16,960,000 lekë) të parashikuara në total 246,873,850 lekë. Këto shpenzime parashikohen të mbulojnë nga të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë.

Për realizimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Projekt-Buxhetit, ASD duhet të operojë në përputhje me procedurat e Ligjit “Për prokurimet publike” dhe Udhëzimet përkatëse të APP-së, si dhe akteve të tjera nënligjore të ASD të zbatueshme.

Për më shumë informacion, po ju paraqesim më poshtë listën e detajuar të të gjithë zërave të shpenzimeve për vitin 2023.

A. SHPENZIME KORRENTE

Këto shpenzime janë llogaritur në vlerën **229,913,850** lekë (14.7% më pak se plani i vitit 2022 dhe 5.7% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022, duke përjashtuar humbjet nga diferencat e rivlerësimit të pritshme për vitin 2022).

Shpenzimet Korrente janë një tregues i rëndësishëm në buxhetin e ASD në funksion të realizimit të qëllimit të saj për sigurimin dhe kompensimin e depozitave dhe të veprimtarisë administrative të saj. Kapitujt kryesorë të shpenzimeve janë:

- SHPENZIME OPERATIVE
- SHPENZIME PERSONELI
- SHPENZIME PËR TATIM TAKSA
- SHPENZIME PROVIGJIONIMI
- SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE
- SHPENZIME TË JASHTËZAKONSHME/TË PAPANASHIKUARA

I. SHPENZIMET OPERATIVE

Këto shpenzime parashikohen në vlerën **110,719,851** lekë (26.7% më pak se plani i vitit 2022 dhe 11.8% më pak se realizimi i pritshëm për vitin 2022). Në vijim po paraqesim një analizë më të detajuar të zërave të shpenzimeve:

Grupi 1

Shpenzimet për materiale dhe të ngjashme, parashikohen në masën **40,223,673** lekë (12.4% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 58.04% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022)

Këto shpenzime përbëhen nga:

Shpenzimet për Telefoni, janë llogaritur në masën **710,000 lekë** (po aq sa plani i vitit 2022 dhe 21.2% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022). Në planifikimin e këtij zëri, jemi mbështetur në faturat faktike të vitit 2022, si edhe në kërkesat e Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në bazë të organikës dhe nevojave për të komunikuar me bashkëpunëtorët, homologët dhe bankat.

Parashikohet që fondi për shpenzimet e linjave fikse të jetë në vlerë 140,000 lekë (po aq sa panifikuar në vitin 2022 dhe 24% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Për vitin 2022, fondi për mbulimin e telefonisë celulare të Zv/Drejtorave të Përgjithshëm, të Përgjegjësve të Sektorëve, dhe Asistentit Administrativ të DP parashikohet në vlerën 390,000 lekë, (po aq sa plani i vitit 2022 dhe 24 % më shumë se realizimi i pritshëm për këtë vit). Sipas akteve që rregullojnë rimbursimin e këtyre shpenzimeve, limiti i mbulimit të shpenzimeve për telefoni celulare të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm është 5,000 lekë në muaj, ndërkohë limiti i mbulimit të shpenzimeve celulare të Përgjegjësve të Sektorëve, si dhe Asistentit Administrativ të DP është deri në masën 2,500 lekë në muaj.

Ndërkohë, po sipas akteve që rregullojnë rimbursimin e këtyre shpenzimeve, mbulimi për shpenzimet e telefonisë celulare të Drejtorit të Përgjithshëm parashikohet në vlerën 15,000 lekë në muaj ose 180,000 lekë për vitin (sa plani i vitit 2022 dhe 14% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin).

Shpenzime interneti, janë llogaritur në vlerën **305,500 lekë** (27.4% më shumë se sa plani dhe 99% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Ky zë përfaqëson koston e shërbimit të internetit në Agjenci për vitin 2023. Parashikimi është kryer nga Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore bazuar në të dhënat faktike të vitit 2022, vijimësisë së kontratës së nënshkruar në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022, si dhe fondit të parashikuar për kontraktimin vjetor të shërbimeve duke filluar nga gjashtë mujori i dytë i 2023. Vlera e buxhetuar për kontratën që do lidhet gjatë vitit 2023, në përfundim të kontratës ekzistuese është llogaritur në vlerën 120,000 lekë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 është parashikuar buxhetimi i vlerës 80,000 lekë për rilidhjen e kontratës për një linjë dytësore interneti, e cila shihet si e domosdoshme për të siguruar një lidhje të pandërprerë të

komunikimit me email, të navigimit në internet apo të raportimit të subjekteve anëtare të skemës, sidomos në rastin e një ngjarje kompensimi, ku shërbimi do të jetë i pandërprerë pas futjes automatike në punë të kësaj linje dytësore. Gjatë vitit 2022 krahas dy linjave të Agjencisë, ishte planifikuar edhe një linjë interneti për disaster recovery site nga STI, e cila nuk arriti të realizohej pasi e lidhur me realizimin e investimit për Disaster recovery, e ribuxhetuar për vitin 2023 në shumën 117,500 lekë. Ky shpezim është i parashikuar për 4 vitë në vlerë 470,000 lekë.

Shpenzimet postare, janë llogaritur në vlerën **60.000 lekë** (50% më shumë se sa plani i vitit 2022 dhe 160% më shumë krahasuar me realizimin e pritur për këtë vit).

Ky zë shpenzimesh përfaqëson koston e korrespondencës zyrtare të Agjencisë me bankat, shoqëritë e kursim kreditit dhe institucionet homologe, si brenda territorit të vendit ashtu edhe jashtë tij, për dërgesat me postën normale dhe atë të shpejtë. Rritja e vlerës së planifikuar në këtë zë vjen si rezultat i nevojave të shtuara për dërgesa të postës zyrtare.

Shpenzime për trajnime dhe specializime të punonjësve dhe KD, janë llogaritur në vlerën **5,600,000 lekë** (11% më pak se plani i vitin i 2022 dhe 51% më shumë se realizimi i këtij viti).

Ky zë shpenzimesh parashikohet të mbulojë trajnimet dhe specializimet e punonjësve të Agjencisë, si dhe pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, Zv/Drejtorëve të Përgjithshëm dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të ASD në konferencat dhe mbledhjet vjetore të organizuara nga shoqata ndërkombëtare dhe europiane e sigurimit të depozitave (IADI dhe EFDI) dhe institucioneve homologe jashtë vendit. Përdorimi i këtij fondi bëhet në bazë të trajnimeve, seminareve, konferencave dhe takimeve që do të zhvillohen në vitin 2023 dhe sipas planeve të punës të miratuara nga struktura përkatëse.

Për vitin 2022, sipas kërkesave të njësive përkatëse të Agjencisë dhe të propozuara nga SABNJ, ky zë është llogaritur bazuar si mëposhtë:

- Pjesëmarrje në takimet vjetore IADI dhe EFDI. Vlera totale e parashikuar është 1,000,000 lekë.
- Pjesëmarrje e Këshillit Drejtues në takime, konferenca dhe mbledhje të organizuara nga organizata ndërkombëtare jashtë shtetit. Vlera totale e parashikuar është 250,000 lekë.
- Pjesëmarrje e Drejtorit të Përgjithshëm në takime, konferenca dhe mbledhje të organizuara nga organizata ndërkombëtare jashtë shtetit. Vlera totale e parashikuar është 1,400,000 lekë.
- Pjesëmarrje e Zv/Drejtorëve të Përgjithshëm në takime, konferenca dhe mbledhje të organizuara nga organizata ndërkombëtare jashtë shtetit. Vlera totale e parashikuar është 1,250,000 lekë.
- Pjesëmarrja e Asistentit të Drejtorit të Përgjithshëm në takime dhe konferenca jashtë shtetit me vlerë 100,000 lekë.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit Juridik.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit të Financës dhe Investimeve.

- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për trajnime dhe specializime për Sektorin e Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit të Administrimit të Riskut.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore.
- Një fond me vlerë prej 200,000 lekë për pjesëmarrje në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga punonjësit e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.
- Një fond prej 200,000 lekë për pjesëmarrje dhe shkëmbim ekspertize me institucionet homologe, me të cilat Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, por jo vetëm.

Vlerat dhe pjesëmarrjet e kërkuara nga sektorët janë paraqitur për efekt përlllogaritje të këtij zëri dhe mund të variojnë nga ato të realizuara faktikisht në bazë trajnimeve/seminareve që do të ofrohen, vlerësimit të rëndësisë së pjesëmarrjes në to dhe miratimit nga strukturave përgjegjëse.

Vlen të përmendet që si pasojë e situatës së pandemisë së krijuar nga Covid-19, zëri i trajnimeve për vitin 2022 nuk është realizuar ose është realizuar një vlerë shumë e vogël. Gjatë vitit 2022 janë realizuar trajnime në mënyre elektronike, të cilët nuk kanë ndikuar në shpenzimet e prashikuara në buxhet.

Shpenzime për seminare dhe konferenca, janë llogaritur në vlerën **2,200,000 lekë** (214% më shumë se sa plani i vitit 2022).

Përgjatë vitit 2023, planifikohen të zhvillohen nga Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave dhe Sektori i Marrëdhënieve me Publikun seminare/trajnime me bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Shqipërisë në vlerën 100,000 lekë dhe seminare/trajnime me Shoqëritë e Kursim Kreditit anëtare të skemës në vlerën prej 100,000 lekë.

Seminaret dhe trajnimet me bankat dhe kryesisht me SHKK-të, kanë në fokus rritjen e mëtejshme të nivelit të edukimit me elementët e skemës, rëndësinë e kontributit të të gjithë faktorëve të përfshirë në realizimin me sukses të procesit të kompensimit, rëndësia shumë e madhe e mbajtjes së të dhënave të depozituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj, etj. Prezantimet në këto takime lejojnë që audienca të ketë qasje të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e Siguruesit të Depozitave dhe sigurojnë kështu reagime të menjëhershme. Situata e krijuar nga pandemia ka ndikuar në mos zhvillimin e këtyre trajnimeve, por megjithatë eksperiencia pozitive e leksioneve të hapura me studentët do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023.

Në këtë zë është parashikuar nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun një fond prej 100,000 lekë për takime me përfaqësues të medias dhe me subjekte të mëdha biznesi, institucione dhe shoqata për mbrojtjen e konsumatorit. Media, si mjet i rëndësishëm informimi, me ndikimin që ka në opinionin publik përbën një partner të padiskutueshëm të ASD-së në përcjelljen e mesazheve të saj. Me qëllim ruajtjen e stabilitetit

financiar në vend, media duhet të ndërgjegjësohet për rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje falimentimi. Komunikimi dhe informimi i grupeve të tjera vlerësohet gjithashtu si i rëndësishëm.

Agjencia planifikon që edhe gjatë vitit 2023, të vijojë bashkëpunimin nëpërmjet ushtrimeve të simulimit, me Bankat Agjente, për realizimin e objektivit kryesor të Agjencisë, kompensimit të saktë dhe të shpejtë të depozituesve, në rast të një ngjarjeje kompensimi. Për këtë arsye, është parashikuar fondi prej 400,000 lekë për kryerjen e një procesi simulimi gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e partnerëve vendas dhe ndërkombëtar me eksperiencë në fushën e kompensimit të depozitave.

Është parashikuar që këtë vit të mbahet në Shqipëri takimi EFDI PR Committee Meeting vlera e parashikuar është 1,500,000 lekë. Objektiv i Komitetit të Marrëdhënieve Publike dhe Komunikimit (PRC) të EFDI është të mbështesë anëtarët duke përputhur përpjekjet e tyre, si dhe duke shkëmbyer përvoja lidhur me të gjitha aspektet e komunikimit me mediat, depozituesit, dhe të tjerë faktorë interesi. Aktiviteti pritet të mbledhë anëtarë të skemës EFDI dhe të zgjasë të paktën 2 ditë.

Shpenzime anëtarësimi, janë llogaritur në vlerën **2,757,000 lekë** (1% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 1% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin).

Mbështetur në Ligjin nr. 53/14, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” Neni 16, pika 1, ” Agjencia shkëmben informacione në bazë të reciprocitetit dhe nënshkruan marrëveshje anëtarësimi ose bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, autoritete mbikëqyrëse dhe institucione të sigurimit të depozitave përgjegjëse të vendeve anëtare ose të huaja.” ASD është anëtare me të drejta të plota pranë dy institucioneve ndërkombëtare: International Association of Deposit Insurance (IADI) dhe European Forum Deposit Insurance (EFDI).

Shpenzimet e anëtarësimin në Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave - International Association of Deposit Insurance (IADI) dhe në Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave - European Forum Deposit Insurers (EFDI), kanë të njëjtën vlerë tarifore si viti 2022, konkretisht tarifa e anëtarësimin të IADI-t në vlerën 18,500 CHF dhe tarifa vjetore e EFDI-t në vlerën 4,000 euro. Rritja e vlerës së parashikuar në këtë zë prej 29,000 lekë për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, vjen si rezultat i ndryshimeve në kursin e këmbimit të frangës ndaj lekut.

Shpenzime për auditim të pavarur dhe konsulencë, janë llogaritur në vlerën **6,940,000 lekë** (38% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 112% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Ky zë shpenzimesh është planifikuar për të përballuar shërbimet e mëposhtme:

- Shërbimet e auditimit të jashtëm në vlerë 1,440,000 lekë (15% më pak se plani i vitit 2022 dhe sa realizimi i pritshëm për këtë vit). Bazuar në ligjin nr 133, datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar mbi vendimin e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë nr 56, dt 03.10.2017 për miratimin e rregullore “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat e administrimit të tij”, pjesë e këtij shërbimi është edhe auditimi i jashtëm i pasqyrave financiare të FNJ. Në vitin 2022 është

nënshkruar kontrata e re me kompaninë e auditit, për shërbimin e auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të ASD dhe FNJ-së për periudhën 2022-2025. Në bazë të kontratës së lidhur, vlera e parashikuar për vitin 2023 është 1,440,000 lekë.

- Shërbimet e auditimit të brendshëm në vlerë 1,800,000 lekë (2% më pak se plani për vitin 2022 dhe 2% më pak se realizimi i pritshëm i këtij viti). Në zbatim të ligjit Ligjit 53/14 “Për sigurimin e Depozitave”, Agjencia është objekt i shërbimeve të auditit të brendshëm. Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për Drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e Agjencisë. Kontrata për shërbimin e auditimit të brendshëm është lidhur nga Agjencia në Qershor të vitit 2021 dhe përfshin auditimin e brendshëm të Agjencisë për vitet 2021-2024.
Fondi i parashikuar për vitin 2023 është llogaritur në bazë të kontratës së lidhur, në vlerën 1,800,000 lekë.

- Asistencë në rishikimin e Manualit të Kontabilitetit në shumën 1,500,000 lekë, fond i mbartur nga viti 2022. Ky projekt është në proces prokurimi dhe pritet të realizohet gjatë vitit 2023. Ky proces është domosdoshmëri, si rezultat i ndryshimeve të konsiderueshme në Standartet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, si edhe ndryshimeve në praktikat kontabël të ndodhura gjatë viteve. Për këtë arsye, është vlerësuar e nevojshme asistencë në procesin e rishikimit të Manualit nga një shoqëri ndërkombëtare auditimi dhe/ose kontabiliteti.
- Penetration test i sistemit informativ qendror parashikuar në vlerë 2,200,000 lekë.
Agjencia, për të testuar sigurinë e infrastrukturës teknologjike aktuale, parashikon të kryej një test depërtimi (penetration test), duke kontraktuar një kompani të specializuar. Testi i depërtimit, konsiston në kryerjen e sulmeve të simuluar kibernetike në infrastrukturën teknologjike të Agjencisë (infrastruktura e jashtme, rrjeti i brendshëm dhe sistemet ËEB), për të identifikuar pikat e dobëta në sigurinë e infrastrukturës aktuale. Synimi i Agjencisë nëpërmjet kryerjes së saj, është testimi i sigurisë së infrastrukturës teknologjike dhe, në rast të identifikimit të problemeve në sigurinë e sistemeve që përdoren, të implementoj përmirësime të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë.

Shpenzime për botime, abonime, njoftime, materiale studimore, dhe publikime. janë llogaritur në vlerën **2,900,000** (10,000 lekë më shumë se plani i vitit 2022 dhe 62% më shumë se realizimi i pritshëm i vitit).

Agjencia, në përputhje me Ligjin Për Sigurimin e Depozitave dhe Planin strategjik, një ndër objektivat kryesore strategjike të saj, ka zhvillimin e një politike efektive të informimit të publikut dhe grupeve të interesit në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave. Gjithashtu, Agjencia kryen veprimtari promociionale, me qëllim informimin dhe edukimin e publikut.

Në këtë zë parashikohen, abonim vjetor të Agjencisë në median ekonomike, të huaj dhe vendase, me qëllim përditësimin me zhvillimet ekonomike-financiare në vend e më gjerë. Vlera e buxhetuar për kontratën që do lidhet gjatë vitit 2023, është llogaritur në vlerën 80,000 lekë (14% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 34% më shumë se sa realizimi i pritshëm i këtij viti)

Gjithashtu, njëlloj si një vit më parë edhe për vitin 2023, me kërkesë të SABNJ, është parashikuar një fond prej 120,000 lekë për publikime të ndryshme në shtypin periodik. Specifikisht në vijim të dispozitave të përcaktuara në rregulloren “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 218 Datë 24.07.2008, e ndryshuar, parashikohet që ky fond të përdoret për publikimin e vendeve vakante në rast të krijimit të tyre, dhe për publikimin e njoftimeve të ndryshme në median e shkruar, rezultat i vendimeve të organit vendimarrës në Agjenci, sipas nevojave të paraqitura gjatë vitit 2023.

Në kuadër të detyrimit ligjor dhe objektivit strategjik për edukimin e publikut dhe grupeve të interesit, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, ka parashikuar një fond prej 1,000,000 lekë lidhur me Bankat dhe 200,000 lidhur me SHKK-të për riprintim të fletëpalosjeve, stickerave, dhe materialeve të tjera edukuese/promovuese, për vitin 2023. Qarkullimi i informacionit është efektiv, i sigurt, transparent dhe i saktë nëpërmjet publikimeve si raportet vjetore, fletë palosje informative, broshura, etj.

Vlera e parashikuar për vitin 2023 është po aq sa plani i vitit 2022 dhe 2 herë më shumë se sa realizimi i këtij i viti, duke qenë se edhe për vitin 2023 janë prodhuar materiale promocionale që lidhen me 20 vjetorin e Agjencisë, dhe janë përdorur për tu shpërndarë në bankat fletëpalosjet ekzistuese.

Në kuadër të vlerësimit në vazhdimësi të efektivitetit të “Strategjisë së Ndërgjegjësimit të Publikut”, SMP parashikon për vitin 2023 anketim/sondazh me tematikë Matjen e Njohurive mbi Sistemin e Sigurimit të Depozitave. Vlera e këtij anketimi buxhetohet 1,200,000 lekë (po aq sa plani i vitit 2022 dhe 12% më shumë se sa realizimi i këtij viti). Anketimi është një nga mjetet më efektive për të vlerësuar njohuritë e target grupeve të lidhur me sistemin dhe skemën e sigurimit të depozitave në vend.

Në kuadër të informimit të publikut për rolin e ASD-së, por duke marrë shkas edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara, edhe gjatë vitit 2023 është parashikuar pjesëmarrja aktive në Javën e Parasë nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në shumën prej 300,000 lekë, një vlerë kjo e njëjtë me planin e vitit 2022 dhe pothuajse 3 herë më shumë se sa realizimi i pritshëm për vitin. Ky aktivitet është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë financiarisht.

Shpenzime për materiale dhe kancelari, janë llogaritur në vlerën **820,000 lekë** (41% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 31% më shumë se realizimi i pritshëm për këtë vit).

Në planifikimin e këtij zëri, Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore është bazuar në nevojat vjetore të ASD-së për materiale dhe kancelari, në eksperiencën mirëadministruese, realizimin e viteve të shkuara etj. Materialet për kancelari të përgjithshme janë parashikuar në vlerë 360,000 lekë. Ky fond parashikohet të jetë 80% më shumë se sa plani i vitit 2022 dhe 10% më shumë se sa realizimi i pritshëm për vitin. Kjo rritje bazohet në nevojat e shtuara në Agjenci për këto materiale, por edhe në çmimet që ofron tregu për materiale zyre, kancelari të përgjithshme etj, sipas nevojave të indentifikuara gjatë vitit në Agjenci.

SABNJ ka parashikuar një vlerë prej 80,000 lekë për blerjen e kartëvizitave, shtypshkrimeve të ndryshme, prodhimin dhe plastifikimin e çertifikatave për Bankat dhe SHKK, lidhje të materialeve (raporti vjetor,

rregullore etj), nevojë kjo e parashikuar duke iu referuar eksperiencës dhe nevojave të paraqitura në vitet e mëparshme.

Gjithashtu, në këtë zë është planifikuar një vlerë prej 120,000 lekë (po aq sa plani i vitit 2022) për blerjen e kartolinave të urimit me rastin e festave apo të tjera, të cilat do t'i dërgohen homologëve dhe institucioneve me të cilat Agjencia bashkëpunon. Kjo vlerë është planifikuar duke iu referuar kostos historike ndër vite në Agjenci.

Fondi për tonera të printerave dhe fotokopjeve është parashikuar në vlerë 260,000 lekë (30% më shumë se sa plani i vitit 2022 dhe 44% më shumë se sa realizimi i pritshëm për vitin). Kjo rritje lidhet me nevojat e shtuara në Agjenci dhe me ndryshimet e tregut të cmimeve.

Shpenzime për pritje dhe dhurata, janë llogaritur në vlerën **1,920,000 lekë** (39% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 61% më shumë se sa realizimi i pritshëm për vitin).

Ky zë përfaqëson pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues, të Drejtorit të Përgjithshëm dhe stafit të ASD-së në takime me personalitete të institucioneve homologe, sektorit bankar dhe institucione të tjera financiare brenda dhe jashtë vendit, si dhe dhuratat që mund t'i bëhen përfaqësuesve të institucioneve të tjera gjatë vitit, si edhe për ato për festat e fundvitit.

Më konkretisht, bazuar në eksperiencën e krijuar ndër vite, me kërkesën e Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore parashikohen:

- Shpenzime për mikëpritje (dreka dhe darka zyrtare) gjatë veprimtarisë së përditshme, takimeve zyrtare të Drejtorit të Përgjithshëm në vlerën 960,000 lekë (140% më shumë se sa plani dhe realizimi i pritshëm i vitit 2022).
- Shpenzime për mikëpritjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues përgjatë mbledhjeve mujore të zhvilluara, takimeve zyrtare me të tretë në ambjentet e Agjencisë gjatë veprimtarisë së përditshme, në vlerën 40,000 lekë (po aq sa fondi për vitin 2022).
- Shpenzime për blerje materiale të personalizuar apo të loguara (si çadra, albume, libra etj), për t'u dhuruar nga Agjencia gjatë vitit 2023 në vlerën prej 700,000 lekë (po aq sa fondi për vitin 2022)
- Shpenzime për dhurata (shporta festive) për të tretë me rastin e festave të fundvitit, në vlerën 120,000 lekë (po aq sa fondi për vitin 2022).
- Shpenzime për blerjen e suvenireve dhe punimeve të ndryshme artizanale, të cilat do të shpërndahen në formën e dhuratave në aktivitetin zyrtar apo atë të përditshëm përgjatë vitit 2023, për personalitete brenda dhe jashtë vendit me të cilët ASD bashkëpunon, në vlerën prej 100,000 lekë (25% më shumë se plani i vitit 2022).

Në planifikimin e tij, SABNJ është bazuar në Udhëzimin "Për kuotat dhe procedurat e kryerjes së shpenzimeve të nevojshme lidhur me aktivitetet zyrtare të ASD" dhe në realizimin e vitit të kaluar.

Shërbime, mirëmbajtje të aktiveve afatgjata, janë llogaritur në vlerën **11,050,973 lekë** (8% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 45% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin).

Në këtë zë është planifikuar një fond shpenzimesh për të garantuar gatishmërinë teknike të Aktiveve Afatgjata ekzistuese dhe të tjera të ngjashme. Ky fond parashikohet të mbulojë kryesisht shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve informatike dhe programeve software. Konkretisht në këtë zë janë parashikuar shpenzimet për shërbimet e mëposhtme:

1. Me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore janë parashikuar shpenzime për larje të automjetit në pronësi të Agjencisë, me një vlerë të buxhetuar 70,000 lekë për kontratën e re një vjecare, që do të lidhet në përfundim të kontratës ekzistuese.
2. Me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje të automjetit në vlerë 200,000 lekë (50% më pak se plani i vitit 2022). Në këtë fond është përlllogaritur vlera prej 120,000 lekë për shërbime mirëmbajtje të automjetit Sharan në pronësi të Agjencisë (për shërbimet filtra, vaj, pjesë kembimi etj), si dhe shërbimi i mirëmbajtjes për automjetin e marrë me qira (leasing) për ASD-në, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtje të saj, për elemente të papërfshirë në kontratën ndërmjet palëve (psh. carje gome, etj), difekte apo ngjarje të paparashikueshme. Ndërkohë në këtë fond është përlllogaritur edhe vlera prej 80,000 lekë për shërbime mirëmbajtje të automjetit në raste emergjence të paparashikuara. Planifikimi në një vlerë më të ulët se viti 2022 (200,000 lekë ose 50% më pak se viti i mëparshëm) bazohet në marrjen me qira (leasing) të një automjeti për nevoja të Agjencisë dhe përdorimit të tij, mirëmbajtja e të cilit nuk është detyrim i ASD. Gjithashtu, kjo ulje i referohet planifikimit për të nxjerrë në shitje automjetin në pronësi të Agjencisë, bazuar në shpenzimet në rritje të riparimit të tij ndër vite.
3. Me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore janë parashikuar shpenzime për kolaudim automjeti 3,000 lekë (po aq sa viti 2022).
4. Me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje të godinës, të makinerive, pajisjese të punës dhe zyrës në vlerë 600,000 lekë Konkretisht ky fond parashikohet të përdoret si mëposhtë:
 - Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime hidraulike-elektrike etj, të ambienteve të Agjencisë në vlerën prej 120,000 lekë.
 - Shpenzime për mirëmbajtje, riparime dyer-dritare, riparime të ndryshme godine, stukime, mirëmbajtje pajisje zyrash, etj. në vlerën 120,000 lekë.
 - Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit planifikuar në vlerë 120,000 lekë (po aq sa viti 2022), bazuar në koston historike dhe në tregun e çmimeve për këtë shërbim.
 - Shpenzime për shërbimin e preventivimit të punimeve që planifikohen të kryhen në kuadër të riparimit të tualeteve në Agjenci. Nisur nga fakti që nevojitet preventivim nga profesionistë të fushës, me kërkesë të SABNJ është vlerësuar e arsyeshme planifikimi i një fondi prej 120,000 lekë për këtë shërbim.
 - Në kuadër të sa u përmend në pikën e mëparshme është vlerësuar si e nevojshme shërbimi i mbikëqyrjes dhe i kolaudimit të punimeve ndërtimore. Per kete arsye, me kërkesë të SABNJ është planifikuar fond prej 120,000 lekësh për mundësimin e këtij shërbimi.

5. Me kërkesë të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje Portal Web në vlerë të buxhetuar 250,000 lekë për kontratën e re, parashikuar në vlerë 500,000 lekë për 24 muaj.
6. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje Softveri të Menaxhimit të Institucionit (ERP për kontaktin e re në përfundim të kontratës ekzistuese në vlerë prej 950,000 lekë.

Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje të infrastrukturës IT në vlerë të buxhetuar 1,200,000 lekë (po aq sa parashikimi për vitin 2022).

Bazuar në kërkesën dhe vlerësimin e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit ky fond do mbulojë mirëmbajtje preventive dhe korrektive për elementët më të rëndësishëm të infrastrukturës IT, sistemet dhe aplikacionet që nuk kanë kontrata të veçanta mirëmbajtje (si psh mail-server, direktoria aktive, pajisjet firewall, rrjeti LAN + wireless, centrali telefonik, pajisjet për dedektim zjarri/hyrje e paautorizuar, kontrolli aksesit, printerat, fotokopjet, pajisjet faks, etj).

7. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit janë parashikuar shpenzime vjetore për mirëmbajtje të Programit të Kompensimit (SIRK) në vlerë 5,364,000 lekë, bazuar në kërkesat e dërgura nga STI. Kjo kontratë ofron mirëmbajtje preventive dhe korrektive për të gjithë infrastrukturën e SIRK për të siguruar funksionimin e saktë të sistemit, si dhe të mundësojë parandalimin dhe rregullimin sa më të shpejt të problemeve të mundshme që mund të dalin gjatë operimit të sistemit. Bazuar në ecurinë e kënaqshme të projektit, propozohet vazhdimi i ofrimit të shërbimeve për “Mirëmbajtjen e SIRK” dhe planifikimin e fondeve të nevojshme në buxhetin 2023.
8. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për mirëmbajtje Disaster Recovery Site, në vlerë të buxhetuar 700,000 lekë (8% më shumë se parashikimi për vitin 2022). Kjo rritje vjen si pasojë e ndryshimit të cmimeve të tregut për këtë shërbim, parashikuar 2,800,000 lekë për 4 vite.
9. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për certifikatë dixhitale exchange një vjeçare, e cila do të lidhet në përfundim të afatit të certifikatës ekzistuese, në vlerë të buxhetuar 70,000 lekë (sa plani për vitin 2022),
10. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për certifikatë dixhitale (SSL) një vjeçare, e cila do të lidhet në përfundim të afatit të certifikatës ekzistuese, në vlerë të buxhetuar 80,000 lekë (po aq sa parashikimi për vitin 2022) .
11. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për certifikatë një vjeçare Veeam Backup Enterprise, e cila do të lidhet në përfundim të afatit të certifikatës ekzistuese, në vlerë të buxhetuar 360,000 lekë (po aq sa parashikimi për vitin 2022).
12. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për certifikatë njëvjeçare Webex, në vlerë të buxhetuar 60,000 lekë (po aq sa parashikimi për vitin 2022)

13. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për Licence sigurie për faqen Web për një afat 1 vjeçar, në vlerë të buxhetuar 43,000 lekë (po aq sa parashikimi për vitin 2022).
14. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për mirembajtje pajisje IT, në vlerë të buxhetuar 120,000 lekë.
15. Me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është parashikuar shpenzim për Licenca Windows 10 Pro për përdorues në vlerë 600,000 lekë.

Shërbime sigurimi të Aktiveve Afatgjata, janë llogaritur në vlerën **610,200.00 lekë** (7.6% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 27% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin).

Në përputhje me detyrimin ligjor për sigurimin e Aktiveve Afatgjata, këtu përfshihen sigurimi i godinës dhe i pajisjeve nga zjarri, tërmeti, vjedhja, etj., ku vlera e buxhetuar për kontratën e re që do të lidhet në vitin 2023 në përfundim të kontratës ekzistuese është 450,000 lekë (29% më shumë se sa plani për vitin 2022), si dhe sigurimi i automjetit Sharan me kontratat TPL dhe Kasko, me një vlerë të buxhetuar për kontratën e re në shumën 120,000 lekë.

Në përlllogaritjen e këtij fondi nga Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore është marrë në konsideratë vijueshmëria e kontratave të sigurimit të nënshkruara në vitin 2022 dhe që do të vijojnë edhe për një periudhë 10 mujore të vitit 2023, si dhe të dhënat mbi tregun e sigurimit në momentin e hartimit të projekt buxhetit.

Gjithashtu, këtë vit njëloj si një vit më parë janë parashikuar shpenzimet në lidhje me shërbimin e ruajtjes së hapësirave të ASD nga një kompani private sigurimi (mbikqyrje nga kompani të specializuara), me një vlerë të buxhetuar për kontratën e re që do të lidhet në përfundim të kontratës ekzistuese në shumën 120,000 lekë. Në këtë zë është parashikuar edhe shpenzimi prej 7,200 lekë për verifikimin e sinjalit të sigurisë fizike e faturuar nga Albtelekom çdo muaj.

Shërbime nga të tretët, ujë, drita, ngrohje etj. janë llogaritur në vlerën **2,300,000 lekë** (11% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 47% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin).

Në parashikimet e këtij zëri, Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore është bazuar në normat e konsumit të vitit të kaluar për këto shërbime, në përlllogaritjen e një fondi që duhet të sigurojë furnizimin me ujë nga ujësjellësi publik, furnizimin me energji elektrike në ambientet e saj, furnizimin me ujë të pijshëm për punonjësit, si dhe shpenzimet për administrimin e ambienteve të përbashkëta.

Bazuar në ndryshimet e mundshme të cmimeve të energjisë elektrike dhe ujit nga ujësjellësi publik, për vitin 2023 me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore është parashikuar vlera 1,500,000 lekë për shpenzime të energjisë elektrike (25% më shumë se sa parashikimi për vitin 2022) dhe 120,000 lekë për UKT (20% më shumë se sa parashikimi për vitin 2022).

Ashtu si një vit më parë, vlera e parashikuar nga Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për shpenzime administrimi të godinës është në vlerën 460,000 lekë.

Në fondin e parashikuar prej 460,000 lekë për administrimin e godinës për vitin 2023, janë të përfshira veç shpenzimeve mujore për mirëmbajtje të zakonshme si përcaktuar në kontratë, edhe shërbime

mirëmbajtje të jashtëzakonshme të këtyre ambienteve të përbashkëta përkatësisht për mirëmbajtje/riparim kapital për ashensorin e përbashkët, riparim kapital të pompës së ujit, gjeneratorit, furnizim me karburant i gjeneratorit, lysterje e ambienteve etj.

Gjithashtu, me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore janë parashikuar fonde për ujë të pijshëm të çertifikuar për punonjësit, ku vlera e buxhetuar për kontratën e re që do të lidhet në vitin 2023 pas përfundimit të kontratës ekzistuese është 120,000 lekë.

Me kërkesë të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe atij Juridik, janë parashikuar fonde në vlerë 100,000 lekë (50% më pak se plani për vitin 2022) për të përballuar shpenzime në lidhje me shërbime përkthimi/noterizimi, etj., të cilat mund të jenë të nevojshme në përmbushjen e marrëdhënieve kontraktuale apo dokumenta të tjera që mund të dalin gjatë vitit.

Shpenzime karburanti, janë llogaritur në vlerën **1,000,000 lekë** (9% më pak se plani i vitit 2022).

Në planifikimin e tij, Sektor i Administratës dhe Burimeve Njerëzore është bazuar në parashikimet për konsumin e karburantit të automjetit për të gjithë shërbimet e nevojshme që do të kryejnë strukturat drejtuese dhe punonjësit e Agjencise për të realizuar objektivat e punës të vitit 2023 (shërbime pune për pjesëmarrje në seminare, për lëvizje të grupeve të verifikimit, shërbimeve administrative, shpërndarje korrespondence, pritje përcjellje të përfaqësuesve të asistencës së huaj etj), dhe në të dhënat historike të shpenzimeve për karburant në vitin paraardhës. Parashikimi në një vlerë më të ulët për vitin 2023 krahasuar me planifikimin e vitit 2022, lidhet me konsumin më eficient të karburantit nga automjeti i marrë më qira. Për këtë arsye është parashikuar të blihet më pak sasi karburanti, edhe pse është marrë në konsideratë edhe rritja e cmimit të tij.

Shpenzime pastrimi dhe higjenizimi, janë llogaritur në vlerën **950,000 lekë** (19% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 9% më shumë se realizimi i pritshëm për këtë vit).

Në këtë kategori parashikohet kontraktimi i një kompanie pastrimi, e cila do të ofrojë shërbimin e pastrimit dhe materialet e higjenizimit për Agjencinë për një periudhë një vjeçare, në përfundim të kontratës ekzistuese. Ky fond është përlogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut për këtë shërbim dhe materialet e pastrimit dhe higjenizimit të përfshira në këtë shërbim dhe kontratës ekzistuese. Shpenzimet e parashikuara për vitin janë 950,000 lekë.

Fondi i parashikuar për lidhjen e kontratës së re për efekt prokurimi është 1,000,000 lekë.

Me kërkesë të SABNJ në këtë grup shpenzimesh është përfshirë edhe një vlerë prej 100,000 lekë për shërbim pastrimi për raste apo situata të paplanifikuara.

Materiale të ndryshme për ruajtjen e shëndetit në punë të punonjësve në vlerë 100,000 lekë, parashikuar për blerjen e materialeve për dhënie të ndihmës së shpejtë të punonjësve gjatë orarit të punës në Agjenci.

Grupi 2

Shpenzime Amortizimi të Aktiveve Afatgjata, janë llogaritur në vlerën **11,521,643** lekë (10.5% më pak se plani i vitit 2022 dhe 139% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).

Ky grup shpenzimesh përfaqëson vlerën e amortizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) dhe Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale (AAJM) të llogaritur në mënyrë sistematike përgjatë jetës së tyre të dobishme, dhe që do të shtohet edhe nga amortizimi i shpenzimeve kapitale në AAM dhe AAJM që janë parashikuar për t'u bërë gjatë vitit 2023 (shih më poshtë për pjesën në lidhje me shpenzimet kapitale).

AAM dhe AAJM	Shpenzime Amortizimi për 2023		
	Nga AAM dhe AAJM ekzistuese në fund të 2022	Nga AAM dhe AAJM që parashikohen në 2023	TOTALI
Ndërtesa	1,959,810	38,400	1,998,210
Instalime Teknike	1,542,196		1,542,196
Pajisje Informatike	3,542,627	1,485,000	5,027,627
Pajisje Pune dhe Zyre	347,493	36,000	383,493
Aktive të patrupëzuara	1,658,333	---	1,658,333
Mjete transporti	911,784		911,784
Totali	9,962,243	1,559,400	11,521,643

Shpenzimet e amortizimit të Pajisjeve teknike janë parashikuar në rritje për vitin 2023, krahasuar me planin e vitit 2022 dhe kjo lidhet me investimet e kryera përgjatë vitit 2022.

Parashikimi i amortizimit të mjeteve të transportit në vlerë 911,784 lekë lidhet me automjetin e marrë me qira operationale. Sipas kërkesave të SNRF 16, mjete duhet të njihet në aktivet e Shoqërisë që e përdor dhe të amortizohet në afatin më të shkurtër midis qerasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Është përlllogaritur amortizimi për 48 muaj sipas afatit të planifikuar të qerasë operationale.

Amortizim mjete të patrupëzuara 1,658,333 lidhet drejtpërdrejtë me amortizimin e AAJM të planifikuara për tu investuar gjatë vitit 2023, pasi AAJM ekzistuese i ka përfunduar jeta e dobishme

Shpenzimet e amortizimit janë përlllogaritur sipas rregullores miratuar me Vendimin e KD nr. 5, datë 30.03.2017 "Për Administrimin e Aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", e ndryshuar.

Grupi 3

Shpenzime financiare, janë llogaritur në vlerën **58,974,534 lekë** (42% më pak se plani i vitit 2022).

Ky grup shpenzimesh përbëhet nga:

Shpenzime për komisione bankare në valutë, 902,480 lekë (3% më pak se plani i vitit 2022 dhe 113% se realizimi i pritshëm 2022). Planifikimi bazohet nga parashikimi i interesit negativ mbi teprica kreditore të mundshme (planifikuar tepricë cash në llogari prej afërsisht 5 milion euro për 30 ditë gjatë vitit më normën 7 bp), pranë RBI për qëllime të titujve. Mbajtja e llogarisë së mjeteve monetare në euro pranë RBI është domosdoshmëri për investimin e mjeteve në valutë në tregjet ndërkombëtare. Në këtë fond është parashikuar edhe interesi negativ që duhet të paguajë Agjencia në rast të mbajtjes së tepricave kreditore në euro pranë RBI. Fondi total i parashikuar është në shumën 500,000 lekë. Përvec komisionit mujor të mirëmbajtjes, në këtë zë është parashikuar edhe vlera prej 102,480 lekë për mirëmbajtjen mujore të shërbimit e-banking të llogarisë në euro pranë RBI.

Komisionet në valutë pranë bankave në vend janë parashikuar në vlerën 300,000 lekë (po aq sa plani i vitit 2022)

Shpenzime për komisione bankare në lekë, 850,000 lek (sa plani 2022 dhe 5.8% më shume se realizimi i pritshëm 2022):

Në këtë zë shpenzimesh janë parashikuar:

1. Shpenzime për komisione në banka të nivelit të dytë në vlerë 100,000 lekë (sa plani i vitit 2022 dhe 87% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022).
2. Shpenzime për komisione në Bankën e Shqipërisë në vlerë 500,000 lekë (sa plani dhe realizimi i pritshëm për vitin 2022). Ky zë përfshin komisione mirëmbajtje për llogaritë e titujve në AFIsAR për fondin e bankave (llogaria në LEK dhe EUR) që Agjencia ka të hapura në BSH. Vlera e planifikuar është bazuar në koston e komisioneve në bazë të kontratës me Bankën e Shqipërisë.
3. Shpenzime për komisione në Bankën e Shqipërisë në vlerë 250,000 lekë (sa plani dhe realizimi i pritshëm për vitin 2022). Ky zë përfshin komisione mirëmbajtje për llogaritë e titujve në AFIsAR për fondin e SHKK-ve (llogaria në LEK) që Agjencia ka të hapur në BSH me qëllim mundësimin e investimit të fondit të SHKK-ve në LVL të Qeverisë. Ky shpenzim do të mbulohet në përputhje me Ligjin Për Sigurimin e Depozitave nga të ardhurat e realizuara nga fondi i SHKK-ve. Vlera e planifikuar është bazuar në koston e komisioneve në bazë të kontratës me Bankën e Shqipërisë.
4. **Shpenzime për interesa/komisione/kredi/hua,** 51,041,708 lekë planifikuar për detyrimet që rrjedhin nga linja e kredisë me BERZH e cila është efektive nga gusht 2021 të jetë në shumën 100 milion euro. Përkatësisht janë parashikuar :
 - shpenzime administrimi (front end fee); 0.5% e shumës në dispozicion ose 14,583,375 lek amortizuar për 9 muaj të vitit 2023.
 - shpenzime angazhimi (commitment fee); 0.5% e shumës në dispozicion për çdo vit ose 36,458,333 lek llogaritur për 7 muaj të vitit 2023.

Shpenzime për tarifa kujdestarie/brokerimi titujt në valutë, janë llogaritur në vlerën 5,976,446 lekë si mëposhtë;

- Tarifë kujdestarie në shumën 3,423,414 lek planifikuar për një portofol 59 milion euro në cmim tregu gjatë 2023 me tarifë 5 bp/vit.
- Tarifa brokerimi planifikuar në shumën 2,264,344 lek për blerje në shumën 15 milion euro gjatë vitit llogaritur me 5bp mbi volumin. Gjithashtu, në këtë zë është llogaritur tarifa e bursës prej 8 bp mbi volumin e tregtuar.
- Komisione për ekzekutimin e veprimeve nga RBI (mungesë e SWIFT) në shumën 278,689 lek (llogaritur për 36 transaksione gjatë vitit me 80 eur çdo transaksion në shumën 0.5 milion euro.
- Rinovim license LEI për transaksionet me tituj në tregjet e huaja në vlerën 10,000 lek.

Shpenzime për qera operationale automjeti; 203,900 lek planifikuar për pagesat e kësteve mujore të qerasë operationale për një automjet të ri për Agjencinë.

Sipas kërkesave të SNRF 16, qiramarrësi duhet të regjistrojë pagesat e qerasë si të ndara për pjesën e principalit dhe të interesit.

II. SHPENZIME PERSONELI

Këto shpenzime janë planifikuar në masën **104,379,000 lekë** (sa plani i vitit 2022 dhe 25% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022). Ky grup shpenzimesh përbëhet nga:

Shpenzime për paga të personelit, janë 69,800,000 lekë (1.6% më shumë se plani 2022 dhe 18.6% më shumë se realizimi i pritshëm 2022). Në llogaritjen e Fondit të Pagave për vitin 2023 kemi mbajtur parasysh ndikimin e faktorëve të mëposhtëm:

1. Strukturën organizative të pagave të miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë dhe Autoriteti Mbikqyrës në Korrik të vitit 2017, të ndryshuar, dhe pagat aktuale të stafit.
Është parashikuar që struktura prej 30 punonjësish do të përfitojë 12 paga gjatë vitit dhe parashikime për shtesa për punë jashtë orarit (6 ditë).
2. Parashikim për ndryshime në shtesat mbi pagë në masën 2% si rrjedhojë e ndryshimeve të mundshme në shtesat për performancë dhe shtesat në vjetërsi pune/kategori për punonjësit gjatë vitit 2022.
3. Parashikim për ndryshime në pagë në masën 8%, si rrjedhojë inflacionit në vend.
4. Një fond i parashikuar për punësimin e një specialisti të jashtëm për një periudhë 6 mujore gjatë vitit 2022 në bazë të nevoja që mund të lindin. Paga maksimale e specialistit të jashtëm është paga bazë e përgjegjës të sektorit. Paga e përdorur për parashikimin është paga e kryespecialistit.
5. Llogaritja e fondit të pagave, pasqyrohet në tabelën “Parashikimet e Pagave për vitin 2023” në Aneksin 4, bashkëlidhur këtij raporti.

Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësorë, janë llogaritur **10,574,000 lekë** (9.9% më shumë se plani i vitit 2022 dhe 25.1% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2022). Ky zë shpenzimesh përbëhet nga kontributi për sigurimet shoqërore dhe kontributi për sigurimet shëndetësore që ASD paguan për punonjësit e saj, si edhe për specialistët e jashtëm të planifikuar, pranë Degës së Tatimeve Tiranë.

Sigurimet shoqërore të detyrueshme, me një vlerë 8,112,000 lekë janë llogaritur mbi bazën e numrit të punonjësve dhe specialistëve të jashtëm, pagës së tyre mujore, dhe mbi bazën e përqindjes (15%) së kontributeve sipas dispozitave ligjore në fuqi (paga maksimale 149,954 lekë) dhe 8% shtesë që parashikohet se mund të aplikohet mbi pagën maksimale duke filluar nga muaji Janar 2023, bazuar kjo në eksperiencën e viteve të shkuara. Llogaritjet detajohen në tabelën në vijim.

	Punonjësit mbi pagën max.		Punonjësit nën pagën max.	Specialistët e Jashtëm	
- Paga Maximale subjekt i Sigurimeve Shoqërore	149,954.00	161,950.32	1,251,852.46	114,670.00	123,843.60
Përqindja mbi Pagën për SSH	15%	15%	15%	15%	15%
- Numri i muajve	0	12	12	0	6
- Numri i Punonjësve (me pagë mbi max)	22	18	-	-	-
- Numri i Punonjësve (me page nën max)	-	-	11	-	-
- Specialistët e Jashtëm (me Pagë mbi max)	-	-	-	0	1
Shpenzime për SSH	-	5,247,190.37	2,253,334.43	-	111,459.24
Shpenzime për SSH		5,247,190.37	2,253,334.43		111,459.24

Sigurimet shëndetësore, me një vlerë 1,412,000 lekë janë llogaritur mbi bazën pagave të përlllogaritura të punonjësve dhe specialistëve të jashtëm, dhe mbi bazën e përqindjes (1,7%) së kontributeve sipas dispozitave ligjore në fuqi. Llogaritjet analitike të këtij zëri jepen në tabelën në vijim.

Totali i pagave vjetore subjekt i Sigurimeve Shëndetësore	65,114,732.04
Përqindja mbi Pagën për Sigurime Shëndetësore	1.70%
Shpenzime për SSH	1,106,950.44

Totali i pagave subjekt i Sigurimeve Shendetesore per specialist te jashtem	686,196.00
---	------------

Përqindja mbi Pagën për Sigurime Shëndetësore	1.7%
Shpenzime për SSH	11,665.33

Sigurimi jetës dhe shëndetit privat për punonjësit, në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar fondi me vlerë 1,050,000 lekë. Ky shpenzim mundëson mbulimin e sigurimit të shëndetit privat dhe të jetës për punonjësit e Agjencisë.

Shpërblime bazë dhe suplementare, janë llogaritur **21,765,000 lekë** (sa plani i vitit 2022 dhe 23.6% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin)

Ky zë përfaqëson shpenzime për shpërblimet vjetore (bazë dhe suplementare) të punonjësve, përcaktuar në Udhëzimin të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 1926 prot., datë 25.09.2013, “Për nivelin dhe strukturën e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve, Drejtorit të Përgjithshëm, dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të ASD”, të ndryshuar, të cilat janë deri në 4 paga mujore, nga të cilat 2 paga mujore (maksimumi) si shpërblim suplementar për rezultate të mira në punë, 1 pagë mujore për pushimet vjetore dhe 1 pagë mujore për festat e fundvitit. Akordimi i dy shpërblimeve të performancës bëhet mbi bazën e kriterëve të miratuara të vlerësimit në punë të punonjësve të ASD. Shpenzimet për performancë janë llogaritur në masën 1.85 paga mujore nga 2 që është maksimumi, duke pasur në konsideratë vlerësimet aktuale të punonjësve dhe ato të pritshme të performancës së punonjësve gjatë vitit 2022. Shpërblimi për pushimet vjetore dhe festat e fundvitit është parashikuar në masën 100 % të pagës totale (mujore) të llogaritur.

Shpenzime për ndihma ekonomike, që konsistojnë në fonde shtesë për personelin për t’i ndihmuar në përbalimin e shpenzimeve në rast ngjarje të rëndësishme si martesë, lindje femije, nevoje shëndetësore të tyre dhe ndonjë fatkeqësie të pjesëtarëve të afërt në familje (parashikuar në Kodin e Punës dhe në rregulloret përkatëse), me vlerë **1,000,000 lekë**. Kjo vlerë, realizimi i të cilës varion nga viti në vit, është parashikuar sa vlera e buxhetore për vitin 2022.

Shpenzime për aktivitete kulturore, festa, e dieta për udhëtime brenda vendit, me vlerë **1,240,000 lekë** (60% më pak se plani i vitit 2022)

Ketu janë parashikuar 500,000 lekë për të mbuluar shpenzimet për dieta, akomodimin dhe transportin e personelit që do të udhëtojnë jashtë Tiranës gjatë vitit 2022 për verifikime të subjekteve anëtare të skemës, Banka dhe SHKK-ve.

Gjithashtu është parashikuar një fond prej 500,000 lekë ose afërsisht 14,700 lekë për person për t’u përdorur për festat dhe aktivitete kulturore si festat kombëtare dhe ato të fund vitit, aktivitete zyrtare, etj. Agjencia parashikon që fondi të përdoret për organizimin e aktiviteteve që ndërthurin elementin celebrues, por që i shërbejnë rritjes së produktivitetit dhe frymës së bashkëpunimit të punonjësve.

Ndërkohë një vlerë prej 120,000 lekësh me kërkesë të Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore është parashikuar për dhurata për fëmijët e stafit të Agjencisë me rastin e festave të fundvitit.

Kriteret e përdorimit të këtyre shpenzimeve përcaktohen në “Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës së personelit të ASD” miratuar me vendim të KD nr.218, date 24.07.2008, e ndryshuar.

Është parashikuar nga SABNJ marrja me qira e automjeteve për nevoja të ndryshme si përshebull gjatë organizimit të aktiviteve në vlerë 120,000 lekë.

III. SHPENZIME PËR TATIM/TAKSA

Këto shpenzime janë planifikuar në masën **15,000 lekë** Agjencia, njësoj si dhe institucione të tjera shtetërore është subjekt i taksave dhe tarifave vendore (taksa e tabelës dhe tarifa e pastrimit), të cilat parashikohen 70% më pak se viti 2022.

Bazuar në Ligjin për Sigurimin e Depozitave, Agjencia është e përgjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi fitimin në lidhje me shërbimin e sigurimit të depozitave dhe të ardhurat nga veprimtaria e sigurimit dhe administrimi i mjeteve financiare.

IV. PROVIGJIONE

Provigjionet e planifikuara në shumën **6,000,000 lekë** (sa plani i vitit 2022), lidhen me implementimin e SNRF 9, për instrumentat financiarë të Agjencisë të mbajtura në monedhë të huaj. Duke filluar nga data 1 Janar 2018, ka hyrë në fuqi standarti i ri i raportimit financiar, i cili ka zëvendësuar standartin e mëparshëm SNK 39. Ky standart ndër të tjera, kërkon që çdo entitet të vlerësojë mundësinë e humbjes në të ardhmen nga instrumentet financiarë. Agjencia ka planifikuar rritjen e instrumenteve financiare në monedhën euro gjatë vitit 2022, të cilat do të ndikojnë edhe shpenzimin e provigjionit për këto instrumente financiare. Fondi i parashikuar për provigjione sipas kërkesave të SNRF 9 në shumën 6,000,000 lekë, do të ndikohet nga kursi i këmbimit dhe vlera e instrumenteve financiarë të mbajtur në monedhën e huaj, si edhe në vlerësimet nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit për këto instrumente financiare.

VIII. SHPENZIME TË JASHTËZAKONSHME/PAPARASHIKUARA

Fondi për shpenzime të paparashikuara është planifikuar në vlerën **3,000,000 lekë** (po aq sa planifikuar edhe në vitin 2022). Bazuar në rregulloren për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të ASD përdorimi i këtij fondi bëhet vetëm me vendim të Këshillit Drejtues. Agjencia propozon planifikimin e këtij fondi për vitin 2023, i cili mund të përdoret nëse vlerësohet e nevojshme për të mbuluar shpenzime të paparashikuara ose të nën-planifikuara në zërat e tjerë të këtij projekt buxheti.

B. SHPENZIME KAPITALE

Shpenzimet kapitale të ASD për vitin 2023 përfaqësojnë shpenzimet për investime të identifikuar nga strukturat përkatëse të Agjencisë si të domosdoshme për vazhdimësinë e veprimtarisë administrative si dhe arritjen e objektivave të ASD në procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave. Vlerat e

paraqitura në këtë projekt buxhet bazohen në kërkesat e Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore dhe Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sektori i Marrëdhënieve më Publikun. Për këtë vit projektet kapitale të paraqitura për shqyrtim kapin një vlerë prej **16,960,000 lekë** (11% më shumë se plani i vitit 2022) dhe përbëhen nga:

I. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Investime të planifikuara nga Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore në total për vitin 2022 janë në vlerë 1,440,000 lekë të listuara si mëposhtë;

Në zërin **Sipërfaqe ndërtimi** është parashikuar një fond prej 1,200,000 lekë nga Sektori i Administratës dhe Burimeve njerëzore me qëllim Rinovimin e tualeteve ekzistuese.

Sipas SABNJ kjo nevojë ka lindur si pasojë e dëmtimeve të riparueshme të pllakave në këto ambiente si rezultat i lëkundjeve të tërmetit në 2019. Nevojitet gjithashtu ndryshimi i paisjeve hidrosanitare, punime hidraulike etj. Punimet dhe ndërtimi i këtyre ambienteve është bërë në vitin 2002. Fond i buxhetuar në vitin 2022 dhe që propozohet të mbartet për vitin 2023.

Në zërin **Makineri dhe Pajisje Zyre** janë parashikuar fonde me vlerë 240,000 lekë nga të cilat;

Është parashikuar një fond në vlerë 120,000 për blerje “Pajisje zyrash” (karrige për punonjësit) në vijim të vlerësimit që SABNJ bën çdo vit të gjedjes së pajisjeve të zyrave si pasojë e konsumit dhe përdorimit të tyre, panvarësisht mirëmbajtjes që i bëhet.

Është parashikuar një fond prej 120,000 lekë nga SABNJ, për blerje të pajisjeve të paparashikuara në rast të defekteve të riparueshme të ndonjë aktivi të Agjencisë.

Investimet nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit janë në vlerë **14,520,000 lekë** të ndara në zëra si mëposhtë;

Në zërin e **Pajisjeve Informatike**, me kërkesë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit parashikohet si mëposhtë;

1. STI ka planifikuar blerjen e kompjuterave zyre dhe/ ose laptop në vlerën 600,000 lekë për të mbuluar nevojat e lindura të punonjësve. STI gjatë kontrolleve të herëpashershme të pajisjeve informatike në Agjenci ka konstatuar probleme në disa prej kompjuterave dhe laptop-ëve, të cilat duhet të rinovohen. Megjithëse, janë kryer mirëmbajtje të vazhdueshme për to, është bërë e pamundur përdorimi i tyre. Gjithashtu, për shkak të situatës së krijuar, janë identifikuar nevoja për laptop, të cilat do të mundësojnë vazhdimësinë e kryerjes së proceseve të punës së Agjencisë, edhe në rastet kur duhet të punohet në distancë.
2. Parashikohet nga STI ndërtimi i një qendre të dyte funksionale për sistemet IT (**Rack dhe server - disaster recovery site**) qendrore të Agjencisë që do të sigurojë vazhdimin dhe vlefshmerinë e sistemeve IT. Kjo qendër e dytë do të kryejë funksione si përdorimin e sistemeve qendrore IT të

Agjencisë në rast dështimi të plotë apo pjesor të qendrës primare, ruajtjen periodike të të dhënave në formë backup nga qendra primare në atë sekondare, me qëllim rekuperimin e të dhënave në rast dështimi apo korrupitimi të tyre apo kthimin mbrapa në një kohë të caktuar sipas vendimit të Agjencisë për arsye verifikimi apo qëllime të tjera teknike e administrative dhe ndërtimin e një infrastrukture IT funksionale për sistemet qendrore të Agjencisë. Ky zë parashikohet në vlerë 8,200,000 lekë.

3. Parashikohet nga STI blerja e bateri set i plotë në vlerë 300,000 lekë për pajisjet e serverit.
4. Parashikohet nga STI Përmirësim i Ambientit për Disaster Recovery për mbrojtjen e pajisjeve teknologjike në vlerë 1,000,000 lekë. Qëllimi i këtij investimi është përmirësimi i kushteve të qendrës së dytë funksionale (DR), duke siguruar përfundim të sigurisë fizike në infrastrukturën teknologjike të kësaj qendre. Implementimi i një sistemi kundër zjarrit, si dhe implementimi i sensorëve të tjerë, do të rrisin mundësinë e parandalimit të rreziqeve dhe ndërhyrjes në kohë, në raste zjarresh, katastrofash dhe situatash të tjera të paparashikuara. Gjithashtu, e nevojshme për rritjen e nivelit të sigurisë, është përmirësim në kushtet fizike të ambientit që do të përdoret për DR, që përfshin ambientin fizik, muret, derë antizjarr, kabllimet, etj.
5. STI ka parashikuar, edhe një fond rezervë prej 120,000 lekë në këtë zë, për blerje pajisjesh informatike të paparashikuara në rast dëmtimesh apo djegieje të pajisjeve aktuale kompjuterike të Agjencisë.

II. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

1. STI ka parashikuar investimin në një Platformë qendrore për mbledhjen dhe menaxhimin e logove në vlerë 3,300,000 lekë. Platforma qendrore për mbledhje dhe menaxhim të logeve të pajisjeve të sigurisë kryen analizë të avancuar të tyre, identifikim qendror të rreziqeve, si dhe automatizim për përgjigje ndaj incidenteve. Nëpërmjet saj do të bëhet e mundur krijimi i workflows dhe skenarëve për përgjigje automatike, gjenerim raportesh dhe informacioni të detajuar në rast sulmesh me qëllim krijimin e ambientit të nevojshëm për përgjigje taktike dhe neutralizim të sulmeve, përmes krijimit dhe menaxhimit të një tërësie rregullash që ekzekutohen automatikisht në rast të një ngjarje. Kjo platformë do të jetë e lidhur me të gjitha pajisjet dhe aplikacionet e sistemit të mbrojtjes të Agjencisë.

2. Sektori Marrëdhënieve me Publikun propozon krijimin e një faqeje web të re në vlerë 2,000,000 lekë. Ku objektivat janë;

- Te rikonsiderohet ana vizuale dhe teknologjike e faqes. Kjo si një nevojë në aspektin e përmirësimit të imazhit duke ardhur më pranë publikut dhe depozituesit në përputhje me teknologjinë e kohës. Faqja që aktualisht është aktive, është amortizuar dhe pas rivlerësimit që i është bërë.

- Duke qënë se aktualisht kjo faqe nuk përshtatet më me teknologjinë e kohës dhe krijon varësi të madhe, për përdorimin e saj, nga subjektet mbështetëse, si dhe probleme me editimin dhe përshtatshmërinë e përmbajtjes me aspektin vizual, është vlerësuar se krijimi i një faqeje të re, do të përmirësonte ndjeshëm eksperiencën e përdoruesve (publikut). Kjo duke sjell dhe një përjasje totalisht të re për përdorimin e saj nga pajisjet mobile, si celularë dhe tablet, në përputhje me aktualitetin.

- Përmirësimi i eksperiencës së përdoruesit nga mobile devices. Faqja e re do të jetë e ripunuar nga ana vizuale dhe e përshtatur me teknologjinë e kohës si dhe me sigurinë e rrjetit.

- Krijimi i paveresise per menaxhimin e faqes nga ana ASD. Nje faqe më bashkëkohore do të lehtësonte përdorimin në mënyrë të pavarur nga ana e administratorit të faqes (Sektori i Marrëdhënieve me Publikun).

Faqa ekzistuese e Agjencisë është ndërtuar në vitin 2014 dhe ka patur një jetëgjatësi prej 3 vitësh, pra aktualisht vlera e saj kontabël është 0.

ANEKSET E PROJEKT BUXHETIT TË VITIT 2023

Në mënyrë të detajuar Projekt-Buxheti i ASD për vitin 2023, paraqitet në ANEKSET Nr. 1, 2, 3, 4,5 dhe 6 bashkëlidhur si pjesë përbërëse të tij.

Përgatitur nga:

Sektori i Financës dhe Investimeve

Kleopatra Kosta

Etida Topi

Bashkëpunuan në nivel teknik:

Lindita Hado

Marilda Shkurti

Leonora Ibrahim

Arben Beja

Blerta Koci

Ermila Petoshati

Ornela Shqarri

Përgjegjëse Sektori SFI